



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Përshëndetje,

- Referuar pikës 1 të kërkesës nr. 2 bëjmë me dije se:

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, ju dërgojmë listën e administratorëve të emëruar në Njësitë Administrative të Bashkisë Shkodër si vijon:

Nr.	Njësia Administrative	Administratori
		Emri e mbiemri
1	Ana e Malit	Adnan Shullani
2	Bërdicë	Xhavit Pëllumbi
3	Dajç	Broz Pjetrani
4	Guri i Zi	Ismet Haxhija
5	Postribe	Avenir Çelaj
6	Pult	Aleksandër Rroku
7	Rrethinat	Gerald Hasaj
8	Shalë	Mikel Kapsaj
9	Shosh	Prele Ahi
10	Velipojë	Klodian Shyti

- Referuar pikës 2 të kërkesës nr. 2 ju bëjmë me dije se:

Në zbatim të ligjit nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”, i ndryshuar, Bashkia Shkodër po zbaton disa nga programet sociale të strehimit, që kanë si qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përballueshëm për familjet që kanë nevojë për strehim.

“Subvencionimi i qirasë në tregun e lirë” si një instrument financiar i programit social të strehimit “Banesa sociale me qira”, mbështet individë/familje që me të ardhurat e tyre nuk përballojnë pagesën e qirasë reale në tregun e lirë.

Me vendim të Këshillit Bashkiak nr. 7, datë 31.01.2024 “Për miratimin e listës së përfituesve dhe vlerës së subvencionit të qirasë për ato individë/familje që nuk përballojnë qiranë në tregun e lirë, për vitin 2024”, është miratuar lista me 47 individë/familje përfituese, nga të cilat 15 prej tyre janë familje njëprindërore.

Njësia e vetëqeverisjes vendore përcakton vlerën konkrete të subvencionimit të qirasë për banesat në pronësi të pronarit social në tregun e lirë, bazuar në ligjin nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”, i ndryshuar si dhe në aktet nënligjore të dala në zbatim të tij. (VKM nr. 362, datë 29.5.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij”).

Masa e subvencionimit të qirasë përcaktohet duke u bazuar në:

- a) *vlerën mesatare të qirasë në tregun e lirë, e cila vlerësohet sipas zonave të ndryshme urbane e rurale të një njësie të vetëqeverisjes vendore;*
- b) *të ardhurat familjare, sipas kategorizimit të pikës 44, të nenit 2, të ligjit nr. 22/2018, i ndryshuar;*
- c) *aftësinë e familjes për të përballuar pagesat mujore të qirasë, sipas përcaktimeve të nenit 3, të ligjit nr. 22/2018, i ndryshuar*

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin!